

## **RELACION**

### **PËR**

### **PROJEKTLIGJIN**

### **“PËR REZERVAT MATERIALE TË SHETIT”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Projektligji i propozuar synon rishikimin dhe përmirësimin e legjislacionit aktual për rezervat materiale të shtetit, kryesisht të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Projektakti ka për qëllim përshtatjen e legjislacionit për rezervat materiale të shtetit me ndryshimet ligjore të bëra së fundmi në fushën e mbrojtjes civile, dhënien zgjidhje disa problematikave teknike të përhershme të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit që rridhnin nga mospërfshirja apo si pasojë e kufizimeve në përmbajtje të një pjese të aktivitetit të saj.

Gjithashtu, nisur nga mangësitë e theksuara gjuhësore dhe të teknikës legjislative, të cilat në kohë janë shndërruar në probleme teknike të prekshme në fushën e krijimit dhe administrimit të mallrave rezervë materiale të shtetit, projektakti ka synuar të japë qartësinë e nevojshme dhe të përbëjë një bazë të fortë konceptuale mbi të cilën të hartohen aktet nënligjore që pritet të miratohen në zbatim të tij.

#### **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA POLITIKE**

Ky projektligj është parashikuar të propozohet për shqyrtim gjatë katërmujorit të parë të vitit 2021, në përputhje me vendimin nr. 1121, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2021”.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit” është produkt i përpjekjeve të përhershme të institucioneve të administrimit të rezervave materiale të shtetit për të përmbledhur në mënyrë kritike dhe për të zgjidhur përfundimisht problematikat teknike që janë hasur për shkak të boshllëqeve ligjore, kufizimeve jopraktike dhe pak efçente në ligjin nr. 9900, datë

10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Më konkretisht, janë evidentuar këto problematika kryesore:

1. Mangësi të theksuara gjuhësore, konceptuale dhe të teknikës legjislative të cilat përbëjnë shkak për keqinterpretime të normave në lidhje me administrimin e rezervave materiale të shtetit;
2. Pamundësi e zbatimit në praktikë të shumë detyrimeve me natyrë teknike që paraqet akti të cilat rezultojnë në rastin më të mirë jo eficient;
3. Mosrregullim i qartë i marrëdhënieve institucionale që krijohen midis institucioneve përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e rezervave materiale të shtetit dhe institucioneve të tjera, kryesisht qendrore, vendore dhe operacionale të mbrojtjes civile;
4. Mosvlerësim i saktë i ndikimit të disa normave të caktuara në kohën e hartimit të tij, duke sjellë përplasje normative apo zbrazëti ligjore, veçanërisht të rrezikshme për mbarëvajtjen e punës gjatë gjendjeve të emergjencës civile;
5. Nevoja për përditësim të legjislacionit për të qenë aktual dhe mbi të gjitha, koherent me ndryshimet e fundit ligjore të miratuara në fushën e mbrojtjes civile.

Adresimi i këtyre problematikave u pa e arsyeshme të bëhet nëpërmjet hartimit të një projektligji të ri, pasi nevoja për ndërhyrje prek nenet kryesore dhe riformulon mbi 70% të përmbajtjes së aktit aktualisht në fuqi.

Projektakti i propozuar pritet të adresojë drejtpërdrejt problematikat e lartpërmendura dhe të rrisë eficientësinë e punës së institucioneve të administrimit të rezervave materiale të shtetit në këtë drejtim. Në përmbajtje të tij janë përfshirë koncepte të reja shumë dobiprurëse për mbarëvajtjen e punës, si bashkëpunimi ndërkombëtar, burime të reja të financimit, të cilat janë më koherente me zhvillimet aktuale të vendit, rikonceptim i bashkëpunimit me subjektet private, duke i trajtuar si partnere kryesore dhe duke parashikuar shkëmbimin e informacioneve dhe eksperiencave me ta etj. Të tilla parashikime ligjore, përveç rritjes së eficientësisë së institucioneve të rezervave materiale të shtetit, pritet të ndikojnë pozitivisht edhe nga pikëpamja financiare.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit” është në përputhje me Kushtetutën dhe në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNITAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVË)**

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

## VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për rezervat materiale të shtetit” përmban në total 27 nene të formuluar në 6 Krerë.

**Kreu I** “Dispozita të përgjithshme” përmban 3 (tri) nene:

- **Neni 1** “Qëllimi dhe objekti” krijon rezervat materiale të shtetit (qëllimi) dhe bën një panoramikë të thjeshtë të përmbajtjes së gjithë aktit (objekti);
- **Neni 2** “Përkufizime” sqaron termat kryesorë të përmendur në të gjithë përmbajtjen e aktit dhe integron/përshtat koncepte të riformuluara në legjislacionin e përditësuar të mbrojtjes civile;
- **Neni 3** “Përdorimi” pasqyron të gjitha rastet kur ligjërohet përdorimi i rezervave materiale të shtetit, si dhe tregon linjën e përgjithshme që duhet të synojë përdorimi i tyre (për të ndërhyrë në mënyrë operative për mbrojtjen e vendit, të popullsisë...).

**Kreu II** “Krijimi dhe përdorimi i rezervave materiale të shtetit” përmban 2 (dy) nene:

- **Neni 4** “Krijimi” përcakton burimet e krijimit të rezervave materiale të shtetit dhe sjell risinë e donacioneve dhe burimeve të tjera të lejuara me ligj, të cilat nuk parashikohen në legjislacionin aktualisht në fuqi;
- **Neni 5** “Grupimi” ka natyrë kryesisht teknike dhe parashikon ndarjen e rezervave materiale të shtetit për nga natyra, funksioni dhe rëndësia e tyre në grupe (A, B dhe C), sipas një vendimi të miratuar nga Këshilli i Ministrave, të propozuar nga ministri, ku të përcaktohen nomenklaturat, limiti minimal dhe gjendja e tyre orientuese. Gjithashtu, në nen përcaktohet edhe konfidencialiteti i këtij informacioni dhe gjendjes faktike të rezervave materiale të shtetit, për shkak të rëndësisë së posaçme që paraqesin.

**Kreu III** “Institucionet e administrimit të rezervave materiale të shtetit” përbëhet nga 6 (gjashtë) nene, me të cilat krijohet institucioni Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit (neni 9) dhe përcaktohen qartë institucionet e administrimit të rezervave materiale të shtetit (Kryeministri (Neni 7), ministri (neni 8) dhe DPRMSH) dhe funksionet e secilit.

**Kreu IV** “Administrimi i rezervave materiale të shtetit” ka në përmbajtje 8 (tetë) nene të cilat kanë natyrë teknike dhe shtjellojnë veprimet e administrimit që kryejnë institucione përgjegjëse për rezervat.

- **Neni 12** “Financimi” përcakton burimet e financimit të krijimit dhe administrimit të rezervave materiale të shtetit, duke sjellë risinë e përfshirjes në to edhe konceptin e donacioneve të ndryshme financiare apo materiale, projektet e investimeve të brendshme dhe të huaja apo burime të tjera që i lejon ligji. Këto risi, përveçse përshtatin legjislacionin me zhvillimet aktuale të vendit, pritet të ndikojnë pozitivisht në pikëpamjen financiare.
- **Neni 13** “Marrja në dorëzim” referon rregullimin e procedurave të marrjes së mallrave në dorëzim, për shkak të shumëllojshmërisë së kësaj veprimtarie, në aktin nënligjor udhëzim i Këshillit të Ministrave, si dhe përcakton detyrimin e përgjithshëm për

mosmarrjen në dorëzim të mallrave të cilat kanë tejkaluar afatin e përdorimit ose në prag të tejkalimit të këtij afati.

- **Neni 14** “*Ndihmat humanitare*” është shprehje e përpjekjeve të institucioneve administruese të rezervave materiale të shtetit për t’i dhënë zgjidhje problematikave të krijuara nga ligji aktualisht në fuqi, për sa i përket mallrave ndihmë humanitare, veçanërisht serioze në situatat e emergjencave civile. Së pari, është parashikuar detyrimi i institucioneve dhe strukturave të tjera për lehtësimin e procedurave që parashikohen për marrjen në dorëzim të mallrave ndihmë humanitare që i dhurohen shtetit shqiptar.

Paragrafi i dytë ka hequr nocionin aktual të vlerësimit rast pas rasti nga Kryeministri të kërkesave për shpërndarje të mallrave ndihmë humanitare në favor të një individi, komuniteti apo personi juridik të përcaktuar nga dhuruesi, për shkak të pamundësisë reale për t’u kryer ky veprim në një kohë emergjence (problematikë shumë serioze gjatë situatës së fatkeqësisë natyrore që shkaktoi tërmeti i datës 26 nëntor 2019, që u zgjidh më vonë me vendimin e KNEC nr. 7, datë 18.12.2019 “*Për përcaktimin e procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së mallrave ndihmë humanitare dhuruar nga donatorë të huaj me destinacion të përcaktuar të një komuniteti*”) dhe përcaktimin se si rregull, përgjegjëse për marrjen në dorëzim në të tilla raste është struktura lokale që përfshin në juridiksionin e saj subjektin pritës. Rregullimi i procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së mallrave në këtë rast bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Rregullimi i procedurave të administrimit dhe shpërndarjes së mallrave në këtë rast bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndër të tjera, ky projektvendim do të bëjë të mundur edhe përjashtimin nga detyrimet doganare të mallrave ndihmë humanitare, pavarësisht faktit që ato nuk do të merren në dorëzim nga DPRMSH.

Gjithashtu, në legjislacionin në fuqi ndihmat humanitare klasifikohen automatikisht si mallra të grupit B. Kjo dispozitë ka përbërë shkak për pengimin e punës gjatë shpërndarjes së mallrave ndihmë humanitare të një natyre të njëjtë me mallra të grupit C, për shkak se parashikohet për këto mallra shpërndarje e tyre me urdhër të ministrit, që në një situatë emergjence nuk mund të zbatohet pa vënë në rrezik efikasitetin dhe shpejtësinë e punës. Kjo problematikë është zgjidhur, duke i kategorizuar ndihmat humanitare në për nga natyra, funksioni dhe rëndësia sipas grupeve të përcaktuara me ligj, e për pasojë edhe administrimi i tyre bëhet sipas dispozitave të përgjithshme të ligjit.

Tjetër problematikë është edhe marrja në ruajtje e mallrave ndihmë humanitare me natyrë mjekësore, sidomos duke mbajtur në konsideratë dhe situatën e krijuar me përhapjen e virusit COVID-19. Projektakti saktëson afatin kohor të ruajtjes në magazinat e DPRMSH-së (deri në 30 ditë). Administrimi i tyre do të bëhet me urdhër të ministrit të Mbrojtjes, nga strukturat e Inspektoriatit Shëndetësor të SHPFA-së dhe Komandës Mbështetëse. Më tej, u vlerësua që procedurat dhe rregullat për marrjen në ruajtje dhe marrjen në dorëzim të mallrave ndihmë humanitare mjekësore të përcaktohen me udhëzime të përbashkët midis ministrit të Mbrojtjes dhe ministrit që mbulon fushën e shëndetësisë për barnat dhe pajisjet mjekësore.

Së fundi, ky nen përforcon parimin e bashkëpunimit të institucioneve në rastet e ofrimit të ndihmës humanitare, duke parashikuar se dhënia e mallrave ndihmë humanitare bëhet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit.

- **Neni 15** “*Freskimi*” shpreh detyrimin për zëvendësimin e një sasive malli që është në limitet e kohëruajtjes ose kur paraqet rrezik zhvlerësimi cilësor me mall të të njëjtës natyrë dhe lloj, duke ruajtur të pandryshuar sasinë, cilësinë dhe vlerën financiare të mallit që zëvendësohet. Në nen përsëritet fryma e bashkëpunimit të institucioneve përgjegjëse me subjekte private dhe publike në funksion të procedurës së freskimit. Freskimi kryhet sipas një plani vjetor të miratuar nga ministri, me propozim të drejtorit të përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit.
- **Neni 16** “*Mirëmbajtja*” shpreh detyrimin për ndjekjen e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me administrimin e rezervave materiale të shtetit dhe subjekteve ekonomike të kontraktuar, me qëllim përkujdesjen efektive të rezervave materiale të shtetit. Ky nen përsërit bashkëpunimin me subjekte ekonomike, me qëllim efikasitetin maksimale gjatë mirëmbajtjes së mallrave rezervë materiale të shtetit.
- **Neni 17** “*Shitja*” përcakton rregullat e përgjithshme mbi rastet dhe procedurat që duhen ndjekur me qëllim shitjen e rezervave materiale të shtetit, duke bërë referimin përkatës në legjislacionin për ankandin publik. Gjithashtu, është përcaktuar se të ardhurat që krijohen nga shitja e mallrave rezervë materiale të shtetit kalojnë në favor të buxhetit të shtetit.
- **Neni 18** “*Seleksionimi*” përcakton rastet kur mund të kryhet veprimi administrativ që zhvlerëson *de jure* artikullin rezervë, që nuk i shërben më qëllimit të këtij ligji.

**Kreu V** “*Bashkëpunimi*” është një risi e legjislacionit për rezervat materiale të shtetit dhe përmban 5 (pesë) nene të cilat janë rrjedhojë e frymës së përgjithshme të bashkëpunimit në gjithë përmbajtjen e aktit.

- **Neni 19** “*Bashkëpunimi ndërkombëtar*” përcakton bazën ligjore ku mbështetet ky bashkëpunim, si dhe fushat, duke veçuar shkëmbimin e informacioneve rreth krijimit dhe administrimit të rezervave materiale të shtetit, organizimin e veprimtarive të përbashkëta, frymën evropiane që duhet të përshkojë veprimtarinë (pika “dh” e paragrafit 1), gjithnjë duke pasur parasysh moskrijimin e mbivendosjeve të përgjegjësive me institucionet e mbrojtjes civile (pikat “b” dhe “c” të paragrafit 1) në rastet e koordinimit të kalimit të kufirit shtetëror dhe shpërndarjes së ndihmave humanitare.
- **Neni 20** “*Bashkëpunimi ndërinstitutional*” parashikon parimin e përgjithshëm të bashkëpunimit gjatë kryerjes së veprimtarive kryesore të administrimit të rezervave materiale të shtetit, duke sjellë risinë e parashikimit të aktivitetit dytësor që Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit kryen në kuadër të bashkëpunimit me organet e procedimit penal, gjatë ruajtjes së mallrave të sekuestruara në cilësinë e provës materiale, me organe të tjera të pushtetit qendror dhe vendor, kryesisht për marrjen në dorëzim të mjeteve të kategorizuara prej tyre si të dala jashtë përdorimit apo në rastet kur mallra pjesë e rezervës materiale të shtetit (kryesisht ato të ardhurat nga konfiskimet) u transferohen atyre, me qëllim shmangien e kostove që mund të ketë buxheti i shtetit, si pasojë e procedurave të prokurimit.
- **Neni 21** “*Mallrat e sekuestruara*” dhe koncepti në tërësi i mallrave të sekuestruara është risi në projektligjin për rezervat materiale të shtetit. Në bazë të nenit 214 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 3, të ligjit nr. 7873, datë 16.11.1994 “*Për sekuestrimin e mjeteve tokësore, detare, e ajrore, me të cilat kryhen vepra penale*”, DPRMSH-ja ka

bashkëpunuar gjerësisht me organet proceduese gjithnjë duke mos vënë në rrezik kapacitetet dhe administrimin e mallrave rezervë materiale të shtetit, megjithatë në ligjin aktual nuk ka pasur një dispozitë që të rregullojë këtë marrëdhënie. Ligji e ka integruar detyrimin për bashkëpunim me organet e procedimit penal, duke parashikuar njëkohësisht risinë e kërkesës për kryerjen e veprimit të administrimit kur organi kompetent vendos/urdhëron një gjë të tillë. Ky parashikim është pasojë e bashkëpunimeve të shumta të suksesshme që DPRMSH-ja ka pasur në këtë veprimtari që zakonisht ka përfshirë shitjen e një prove materiale që rrezikonte zhvlerësimin (njëkohësisht edhe dëmtimin e mallrave të tjera të magazinuara) dhe depozitim të ardhurave në llogari të veçanta në Thesarin e Shtetit, për t'iu kaluar më pas vlera subjektit përfitues (të akuzuarit, nëse është i pafajshëm, një personi pronar të sendit apo shtetit), sipas vendimit të formës së prerë.

- **Neni 22** “*Bashkëpunimi me AKMC-në*” nënvizon bashkërendimin e punës me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në situatat që parashikon dhe rregullon legjislacioni për mbrojtjen civile. Riformulimi i përmbajtjes së projektligjit në përgjithësi dhe neni në veçanti i ka dhënë zgjidhje problematikave që rezultuan si pasojë e mbivendosjes së përgjegjësive në kuadrin e ndërhyrjes operationale me mallra rezervë materiale të shtetit.
- **Neni 23** “*Detyrimi për bashkëpunim në kohë rreziku*” është gjithashtu një risi në konceptin e projektligjit. Sipas këtij neni, në kuadër të marrjes së masave të jashtëzakonshme, kur verifikohen rastet e gjendjes së jashtëzakonshme, në situata të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, në situata të fatkeqësisë natyrore, të fatkeqësive të tjera apo emergjencës civile dhe në situata të krizës humanitare, me propozim të ministrit, Këshilli i Ministrave vendos detyrimin e subjekteve ekonomike private (të cilët duhet të përcaktohen shprehimisht në vendim në kuadër të garantimit të të drejtave), të cilat ushtrojnë veprimtari prodhuese dhe/ose tregtare me artikuj të caktuar që bëjnë pjesë në nomenklaturën e mallrave rezervë materiale të shtetit, të hyjnë në marrëdhënie kontraktore me DPRMSH-në, me qëllim ruajtjen, mirëmbajtjen, plotësimin apo përtëritjen e artikullit rezervë materiale të shtetit. Realizimi i kësaj dispozite duhet të shihet e lidhur ngushtë me funksionin e DPRMSH-së të përcaktuar në pikën “i”, të neni 10 të projektligjit, sipas të cilës DPRMSH-ja analizon në mënyrë periodike tregun në funksion të eficientës në bashkëpunimin me subjektet ekonomike private, si dhe zhvillon aktivitete informuese, dialoguese dhe shkëmbime eksperiencash në këtë kuadër. Vetëm në sajë të këtij bashkëpunimi mund të arrihet efektshmëria e vendimit të Këshillit të Ministrave eventual që mund të miratohet si në pikëpamjen e mundësisë prodhuese/kapaciteteve të secilit subjekt, ashtu edhe për të garantuar mosçenimin për aq sa është e mundur të interesave të subjekteve private.

**Kreu VI** “*Dispozita kalimtare dhe të fundit*” përmban 4 (katër) nene me natyrë teknike ligjore ku parashikohet detyrimi sipas subjekteve për të nxjerrë aktet nënligjore (neni 24), periudha transitorë për zbatimin e akteve nënligjore të miratuara, para hyrjes në fuqi të projektligjit deri në momentin e nxjerrjes së aktit nënligjor në zbatim të tij (neni 25), shfuqizimi i ligjit aktual nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar, (neni 26) dhe hyrja në fuqi e ligjit (neni 27).

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Drejtoria e Rezervave Materiale të Shtetit dhe secili institucion dhe organ i përmendur në përmbajtjen e aktit.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIUBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Në hartimin e projektaktit kanë marrë pjesë drejtoritë operative të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, si dhe grupi i punës i ngritur me urdhrin e ministrit të Mbrojtjes nr. 183, datë 12.02.2020 *“Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit”, i ndryshuar”*.

Gjithashtu, grupi i punës ka ftuar në konsultim paraprak disa operatorë ekonomikë, që tregtojnë mallra të cilët janë objekt i punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të cilët dhanë sugjerime.

Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Brendshme, në Këshillin Konsultativ të Vetëqeverisjes Vendore, si dhe në Departamentin e Administratës Publike.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMET BUXHETORE**

Projektligji i propozuar nuk paraqet efekt financiar shtesë për buxhetin e shtetit.

**PROPOZUESI**

**MINISTRI I MBROJTJES**

**Niko Peleshi**